



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 dhjetor 2016
Nr. Ref.: RK1030/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/16

Parashtrues

Nafije Bakalli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0189, të 18 shkurtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nafije Bakalli nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin (AC-II-12-0189) e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 18 shkurtit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe neni 1 [Mbrotjtja e pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 korrik 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 22 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që t'i dorëzojë vendimet e kontestuara dhe dokumente tjera relevante.
8. Më 4 gusht 2016, parashtruesja e kërkesës i dorëzoi vendimet e kontestuara në Gjykatë.
9. Më 23 gusht 2016, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
10. Më 7 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 2 tetor 2000, parashtruesja e kërkesës lidhi kontratë për shitblerjen e lokalit nr. 138 me Shoqërinë Aksionare "Agimi" nga Gjakova (në tekstin e

mëtejme: SH. A. "Agimi"). Kjo kontratë mbi shitblerjen e lokalit nuk u vërtetua asnjëherë nga Gjykata dhe bartja e pronësisë në bazë të kësaj kontrate nuk u regjistrua asnjëherë në librat kadastralë.

12. Më 11 prill 2006, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padinë kundër të paditurës SH. A. "Agimi" për vërtetimin e pronësisë mbi lokalin, në Kolegjin e Specializuar të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).
13. Më 24 prill 2007, Kolegji i Specializuar (me Aktvendimin SCC-06-0155) e barti kompetencën dhe e referoi padinë në fjalë për shqyrtim në Gjykatën Komunale në Gjakovë.
14. Parashtruesja e kërkesës me padi kërkoi njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe regjistrimin e pronës në emrin e saj (padi tëses). Parashtruesja e kërkesës në padi pretendoi se ky ishte rasti i tretë i shitjes së lokalit nga SH. A. "Agimi" dhe se blerësve tjerë u është njohur e drejta në lëndët e Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06).
15. Në Gjykatën Komunale e paditura SH. A. "Agimi", nëpërmjet të të autorizuarit të saj, deklaroi *"se lokali në fjalë i është shitur blerëses sipas procedurave të parapara me Statutin e të paditurës dhe me ligjet në fuqi, andaj nuk e konteston të drejtën e blerëses të lokalit lëndor nga ana e padi tëses sepse të gjitha obligimet të cilat i ka pasur i ka kryer ndaj palës padi tëse"*.
16. Në këtë procedurë para Gjykatës Komunale, në cilësinë e ndërhyrësit, është paraqitur e para Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM), e cila u pasua nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
17. AKP-ja e kontestoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtrueses, duke pretenduar se kontrata ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe SH. A. "Agimi" është e kundërligjshme që nga lidhja e saj mbi disa baza juridike.
18. Më 29 qershor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë (me Aktgjykimin C. nr. 354/07) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës për njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe për regjistrimin e pronës në emrin e saj.
19. Gjykata Komunale gjeti se kontrata e lidhur ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe SH. A. "Agimi" ishte e paligjshme mbi disa baza juridike dhe që: e paditura nuk e kishte të drejtën për ta shitur lokalin në bazë të ligjit në fuqi; se kontrata nuk kishte vlerë ligjore sepse nuk ishte e vërtetuar nga organet shtetërore; se në momentin e shitblerjes, objekti i shitblerjes (lokali) nuk ekzistonte; dhe këstet e pagesës nuk ishin paguar sipas afateve të përcaktuara me kontratë.
20. Më 10 mars 2010, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër (Aktgjykimit C. nr. 354/07) të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Parashtruesja në ankesën e saj kërkoi që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale dhe të kthehet lënda për rigjykim, për shkak të vërtetimit të gabuar

dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore.

21. Më 30 nëntor 2012, AKP-ja parashtroi përgjigje në ankesë, duke pretenduar se SH. A. "Agimi" "në atë kohë nuk mund të shiste apo blente pa pëlqimin e UNMIK-ut".
22. Më 18 shkurt 2016, Kolegji i Apelit (me Aktvendimin AC-II-12-0189) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 354/07 e Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Në esencë, të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës mund të përmbliidhen në:

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera të Kushtetutës dhe me konventat ndërkombëtare

24. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se është e diskriminuar, sepse në "praktikën gjyqësore në Kosovë [...] në çështjet juridike C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 në situata krejtësisht identike u ka aprovuar kërkesat palëve".
25. Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se "... ka edhe lokale tjera që janë shitur nga e paditura pas lufte dhe prona u është bartur".

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

26. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës citon edhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës, duke theksuar se "... Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me dt. 21 maj 2008, ...", ndërsa "Raporti juridik në mes të palëve është krijuar dukshëm më herët, para se të themelohet AKM dhe pastaj AKP".
27. Në bazë të asaj që u tha më lart, parashtruesja e kërkesës konkludon se "dispozitat në të cilat bazohen aktgjykimet e atakuara nuk mund të aplikohen retroaktivisht, në dëm të parashtrueses së kërkesës".

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe me nenet e tjera

28. Parashtruesja konsideron se AKP-ja kishte ndërhyrë në procedurë në kundërshtim me funksionin e ndërhyrësit, të përcaktuar me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas pretendimeve të parashtrueses statusi i tillë juridik i AKP-së "e bënë aktgjykimin e atakuar të pa qëndrueshëm për shkak të konfliktualitetit të ndërhyrësit gjatë procedurës me palën të cilës i është bashkuar, çka me ligj nuk është e lejuar".

29. Më tej, parashtruesja e kërkesës *“konsideron se ky gjykim është përfshirë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, përkatësisht nenit 6 - E drejta për një proces të rregullt të Konventës për mbrojtjen e së drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ...”*.
30. Në kuadër të këtyre pretendimeve, parashtruesja e kërkesës citon nenin 22 të Kushtetutës dhe pohon më tej se *“Interesi i rendit kushtetues, i respektimit të normave minimale, standardeve minimale të përcaktuara me dispozita të konventave ndërkombëtare të cilat e obligojnë edhe Republikën e Kosovës duhet të imponojnë ndalimin e menjëhershëm të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të transformuara në aspektin pronësor”*.
31. Parashtruesja e kërkesës i propozon Gjykatës:
- “... të anulojë dhe të shpallë kundërkushtetuese Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të GJSK për çështje që lidhen me AKP AC-II-12-0189 dt. 18.02.2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 354/07 të dt. 29.06.2009, për shkak se aktgjykimet nuk kanë qenë fer...”*

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
34. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”*.
35. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesja i ka përmbushur kërkesat procedurale të nenit 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesja i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera të Kushtetutës dhe konventat ndërkombëtare

37. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata së pari i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thekson se “*diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme*” (Shih, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002, dhe *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006).

38. Gjykata më tej rikujton se në mënyrë që pretendimet e parashtrueses, në lidhje me shkeljen e të drejtës për diskriminim të mund të jenë të suksesshme, ata *inter alia*, duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet ngjashëm me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (Shih, *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 18 shkurtit 1991).

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se është diskriminuar, sepse “*në praktikën gjyqësore në Kosovë [...] në çështjet juridike C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 në situata krejtësisht identike u ka aprovuar kërkesat palëve*”.

40. Mirëpo, parashtruesja e kërkesës nuk e dorëzon dokumentacionin nga “*lënda C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06*”, por më tej thekson “*... se ka edhe lokale tjera që janë shitur nga e paditura pas lufte dhe prona u është bartur*”.

41. Gjykata vëren se, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 354/07) e trajtoi këtë çështje të ngritur nga parashtruesja e kërkesës, ku “*... në cilësinë e provës i administroi edhe shkresat e lëndës C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 të formës së prerë, mirëpo meqë të njëjtat ishin irelevante për vendosjen ndryshe të kësaj çështje nuk bëri ndonjë analizë të veçantë ndonëse në sistemin tonë juridik nuk aplikohet e ashtuquajtura “e drejta e precedentit”*”.

42. Prandaj, Gjykata konstaton se Gjykata Komunale në Gjakovë në lidhje me këto pretendime të parashtrueses dha një përgjigje të arsyeshme, dhe se ajo nuk arriti të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës.

(ii)Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

43. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GJEDNJ në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të cilat janë të aplikueshme edhe me nenin 46 të Kushtetutës dhe e arsyetojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës në pronë (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 35 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 2004; *MALTZAN (FREIHERR VON) dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, paragrafi 74, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri, i 2 marsit 2005).
44. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk është bërë bartëse e të drejtës pronësore; përkundrazi, ajo është përpjekur ta fitojë pronën, do të thotë se parashtruesja e kërkesës kishte vetëm “shpresë për njohjen e të drejtave pronësore, e cila është e pamundur të arrihet efektivisht”, prandaj kjo gjendje juridike “nuk mund të konsiderohet si “pronë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1”.
45. Të gjitha “pritjet legjitime” të saj se ajo do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës ishin të bazuara në kontratën e cila nuk është vërtetuar nga asnjë autoritet publik, për të cilën Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Kolegji i Apelit konstatuan se “ishte lidhur ultra vires dhe nuk ia barti të drejtën e pronës palës kontraktuese”.
46. Edhe pse parashtruesja e kërkesës thirret në “zbatimin retroaktiv të së drejtës”, Gjykata vëren se ajo këtë nuk e arsyeton në asnjë mënyrë.
47. Gjykata vëren se çështja kryesore që u ngrit në gjykatat e rregullta ishte çështja e “bazës ligjore për fitimin e të drejtës pronësore”, për të cilën Gjykata Komunale në Gjakovë arsyetoi se, në rastin konkret:
- “E paditura nuk e kishte të drejtën për ta shitur shitoren në bazë të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1, [...]e cila thotë se UNMIK-u administron pasurinë e tundshme dhe të patundshme, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe format e tjera të pronës të regjistruara në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, të cilat gjendet në territorin e Kosovës”.*
48. Më tej, Gjykata Komunale arsyetoi se “kontrata nuk kishte vlerë ligjore dhe ishte e paligjshme për faktin se nuk ishte e legalizuar dhe nuk ishte e mundur të legalizohej nga ndonjë organ kompetent gjyqësor”.
49. Përveç kësaj, Gjykata Komunale gjeti se “nga referati i padisë shihet se (në momentin e shitblerjes) dyqani - lokali si pasojë e luftës së fundit në Kosovë, ka qenë tërësisht i shkatërruar. Andaj, në raport me përmbajtjen: kontrata është nule, jo vetëm “kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejuar, i pa caktuar ose i pa caktueshëm” neni 47 i LMD”.
50. Në fund, Gjykata Komunale konkludoi që “peditësja poqëse i shpreson suksesit në kontest mund të ushtroj padi kundër të paditurës për kthimin e shumës së

paguar të çmimit të kontraktuar të shitblerjes të lokalit lëndor sipas kontratës”.

51. Një përfundim i tillë i Gjykatës Komunale është mbështetur edhe nga Kolegji i Apelit, i cili më tej konstatoi se *“Menaxhmenti i SH. A. “Agimi” nuk kishte kompetenca për të shitur ndonjë aset pa autorizimin e UNMIK-ut sipas nenit 6. 1. b të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/54, që ishte e zbatueshme në kohën e përpjekjes së blerjes. Kontrata në fjalë ishte lidhur ultra vires dhe nuk ia barti të drejtën e pronësisë palës kontraktuese. Përveç kësaj, kontrata nuk është vërtetuar asnjëherë në gjykatën me kompetencë territoriale”.*
52. Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludon se parashtruesja nuk arriti t'i paraqes dhe t'i mbështes pretendimet për *“zbatimin retroaktiv të së drejtës”* janë të pabazuara. Gjykata konsideron se Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Kolegji i Apelit kanë dhënë përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës, përkritazi me arsyet e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe të asaj materiale.
53. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës ka lidhur marrëdhënie kontraktuale që është *void ab initio*; kjo punë juridike ka qenë e pavlefshme që nga fillimi, dhe rrjedhimisht një punë e tillë juridike nuk mund të konvalidohet më vonë.
54. Nga ajo që u tha më lart, Gjykata rikujton se *“pritshmëria legjitime”* nuk mund të ndodhë *“në qoftë se ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit të brendshëm”*; prandaj, në bazë të të gjithave që u prezantuan, Gjykata konkludon se me vendimet e gjykatave të rregullta nuk është shkelur neni 46 i Kushtetutës as neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe që këto nene nuk garantojnë të drejtën e fitimit të pronës (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 të Aktgjykimit të GjEDNJ-së, të 28 shtatorit 2004).

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe nenet e tjera

55. Parashtruesja e kërkesës pretendon se AKP-ja kishte ndërhyrë në procedurë në kundërshtim me funksionin e ndërhyrësit, të përcaktuar me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas pretendimeve të parashtrueses statusi i tillë juridik i AKP-së *“e bënë aktgjykimin e atakuar të pa qëndrueshëm për shkak të konfliktualitetit të ndërhyrësit gjatë procedurës me palën të cilës i është bashkuar, çka me ligj nuk është e lejuar”.*
56. Parashtruesja e kërkesës, më tej, konsideron se është shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës, dhe pretendon më tej se *“interesi i rendit kushtetues, i respektimit të normave minimale, standardeve minimale të përcaktuara me dispozita të konventave ndërkombëtare të cilat e obligojnë edhe Republikën e Kosovës ... ”.*
57. Gjykata përsëritë që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara të aplikimit të ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat

dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, paragrafi 28 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999).

58. Sidoqoftë, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i zgjidhin çështjet e interpretimit të ligjit. Kjo veçanërisht vlen për aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e të drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e rregullta (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, veçanërisht ato të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
59. Parashtruesja e kërkesës konteston aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e tyre nga ana e gjykatave të rregullta. Këtë interpretim e kanë arsyetuar gjykatat e rregullta në dy shkallë. Ky përfundim u arrit nga gjykatat e rregullta pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës.
60. Parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në fazat e ndryshme të kësaj procedure të paraqesë argumentet dhe provat që i konsideroi të rëndësishme për rastin e saj. Njëkohësisht, asaj i është dhënë mundësia për të kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë dhe ta kontestojë interpretimin e ligjit në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe Kolegjin e Apelit në procedurë të rregullt gjyqësore.
61. Gjykata konsideron se vendimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Kolegjit të Apelit janë të drejta dhe të arsyeshme. Në fakt, ato shpjegojnë në detaje përse kontrata e shitblerjes është juridikisht e pavlefshme, dhe se ajo është lidhur *ultra vires* dhe për këtë arsye ai nuk kishte bartur të drejtën e pronësisë palës kontraktuese.
62. Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë përmbushur. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës.
63. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

